



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 16334 Prot

Lezhë, më 26/10/2023

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja “a” dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr. prot. 358/1, datë 15.05.2020, i ndryshuar, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës (Tetor 2023) të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e martë, në datën 31.10.2023, në orën 12:00, në sallën e Bibliotekës “At Gjergj Fishta” Lezhë, me këtë

REND DITE:

1. Informacion mbi furnizimin me energji elektrike të Bashkisë Lezhë dhe problematikat që kërkojnë zgjidhje nga z. Gentian Fiçorri, Koordinator i OSHEE Lezhë.
2. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-30 Shtator 2023”
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasit F.GJ.T., F.P.M. DHE I.R.K. nga fondi i emergjencës”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e përmbajtjes dhe modeleve të akteve për kundërvajtjet në pyje”
5. Projekt-Vendim “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes së fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Lezhë, për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet”
6. Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 120, datë 02.12.2022 “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për 4 mujorin e dytë të vitit 2023”
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e nivelit të taksave, tarifave vendore për shërbimet publike dhe ato administrative, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundravajtësve”
9. Projekt-Vendim “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 13, datë 27.07.2023 “Për miratimin e pagave të administratës së bashkisë, të njësisve administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësisve mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave”

10. Projekt-Vendim "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara, vendbazimeve ujore dhe zonave të shërbimeve në vijën bregdetare Shëngjin dhe Tale për sezonin turistik veror 2024"
11. Projekt-Vendim "Për miratimin e Komisionit Qendror për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në Bashkinë Lezhë"
12. Projekt-Vendim "Për ndryshimin e emërimit të rrugës nga "Çamëria" në "Zef Toma"
13. Projekt-Vendim "Për ndryshim dhe emërtim rrugësh në fshatin Gajush"
14. Projekt-Vendim "Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" z. Frano kulli, z. Ismet Zusi, Z. Nikolin Ivanaj, Z. Marash Marku, Z. Qemal Minxhozi, z. Salvador Gjeçi"
15. Për njohje, informacion mbi zbatimin e Buxhetit për 9-mujorin e vitit 2023.
16. Interpelancë me Kryetarin e Bashkisë z. Pjerin Ndreu për gjendjen ekonomiko-financiare të Bashkisë Lezhë, kërkuar nga këshilltarja znj. Alfrida Marku.
17. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Strehimit	E hënë	30.10.2023	10:00
2	Komisioni i Sigurisë Publike dhe Emergjencave Civile	E hënë	30.10.2023	10:15
3	Komisioni i Bujqësisë	E hënë	30.10.2023	10:30
4	Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik	E hënë	30.10.2023	11:00
5	Komisioni i Kulturës dhe Titujve	E hënë	30.10.2023	12:00
6	Komisioni i Urbanistikës, Programeve të Zhvillimit dhe Integritit	E hënë	30.10.2023	12:30

**KRYETARI
NDUE LULI**

